



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 29.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **28.10.2025**, të parashtruar nga OE "Global Holding" SH.P.K. si dhe kërkesën për rishqyrtim të OE **NIKA Pro- Ing SH.P.K.** e datës 29.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER "Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti"** me nr. prokurimi 206-25-8662-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohen**, si të pa bazuara kërkesa për ri-shqyrtim e OE "Global Holding" SH.P.K. e datës 28.10.2025, si dhe kërkesa për rishqyrtim e OE **NIKA Pro- Ing SH.P.K.** e datës 29.10.2025 si e Jashtafatshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit **RITENDER "Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti"** me nr. prokurimi 206-25-8662-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 24.09.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontratë i datës 24.09.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE "Global Holding" SH.P.K. me datën 28.10.2025 dhe OE **NIKA Pro- Ing SH.P.K.** me datën 29.10.2025, kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER "Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti"** me nr. prokurimi 206-25-8662-5-1-1. Autoriteti Kontraktues me datë 29.10.2025 i ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE "Global Holding" SH.P.K.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 51 Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
RREGULLORJA NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK
Neni 4.3 i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik
Neni 17.17 i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik
Neni 24 i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE NIKA Pro-Ing SH.P.K.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 51 Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
RREGULLORJA NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK
Neni 4.3 i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik
Neni 17.17 i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik
Neni 24 i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik

Pretendimet ankimore të OE ankues "Global Holding" SH.P.K.

Ne perputhje me rregullat e prokurimit dhe ne perputhje të plot me LPP-ne, shtojm këto kërkes për rishqyrtim.

Pretendimi 1.

Në lidhje me Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (pikat 8.1 & 8.2) të dokumenteve të tenderit, konkretisht:

“OE ose GOE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024) ka qenë në vlerë të përbashkët jo më pak se njëzet (20) milionë euro.

Në rast të grupit të OE-ve, së paku 51% e qarkullimit duhet të plotësohet nga lideri i grupit.”

Konsiderojmë se ky kriter është në kundërshtim me parimet bazë të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht me Nenin 1 – Qëllimi dhe fushëveprimi, i cili përcakton se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë:

përdorimin sa më efikas të mjeteve publike;

konkurrencë të drejtë dhe të hapur ndërmjet operatorëve ekonomikë;

trajtim të barabartë dhe pa diskriminim;

transparencë në të gjitha procedurat e prokurimit publik.

Vendosja e kufizimit që lideri i grupit duhet të ketë minimalisht 51% të qarkullimit të përgjithshëm paraqet kriter diskriminues dhe kufizues, i cili nuk është i domosdoshëm për qëllimet e kontratës dhe bie ndesh me parimin e konkurrencës së hapur. Ky kusht kufizon mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë të kualifikuar, të cilët mund të plotësojnë kriterin e përgjithshëm financiar në mënyrë të përbashkët, ashtu siç e lejon LPP dhe praktikën e mira të BE-së në prokurim publik.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë këtë kriter dhe ta largojë kërkesën për përqindje minimale (51%) të qarkullimit nga lideri i grupit, duke lejuar që kriteri i qarkullimit të trajtohet në nivel të grupit të operatorëve ekonomikë (GOE) si një e tërë.

Gjithashtu ju NUK e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Ju si Autoritet Kontraktues duhet të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të nxjerrin:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE *Global Holding SH.P.K.*
Rr. Prishtinë

OBLIGOHET AK-MINISTRIA E SHËNDETËSISË Prishtine të largoj kërkesat kundërligjore, të aplikoni dispozitat e Nenit 53.7 të LPP-se si dhe duke korrigjuar versionon e fundit të Dosjes së Tenderit në të cilën duhet të identifikohen ndryshimet konform korrigjimeve të bëra.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Pretendimet ankimore te OE ankues NIKA Pro-Ing SH.P.K.

Bazuar ne Nenin 108/A parashtrojmë kerkese per rishqyrtim ngase përmes kërkesave kualifikuese keni kufizuar konkurrencën ne ate menyre qe te lidhni kontrate me kompani te parapërcaktuar.

Tek kërkesat e Kapaciteti ekonomik dhe financiar lidhur me makinerit keni kërkuar mjete te panevojshme dhe diskriminuese.

Keni kërkuar Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve të fundit (2022-2023-2024) ka qenë në vlerë se bashku në të tri vitet jo me pak se njëzet (20) milion Euro. Ne rast te grupit te OE, se paku 51% te qarkullimit te plotësohet nga lideri i grupit.

Në lidhje me këtë kërkesë, kërkojme qete largohet kriteri prej 51% nga lideri, por te kerkohet ne pergjithesi nga GOE te plotësohet.

Kerkesa e tille tregon per kufizim te hapur te konkurrencës dhe eliminim te kompanive qe posedojnë kapacitete teknike.

Kërkesa e tille e aplikuar per kete procedure disponohen vetëm nga ndonje OE i caktuar, dhe ju si AK keni vendosur kërkesa te tilla me te vetmin qellim qe te lidhni kontrate me kompani te caktuar.

Prandaj, kërkojmë me mirëkuptim që ky kriter të hiqet dhe të riformulohet ndaj grupit të OE ne teresi, në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrje e barabartë e të gjithë operatorëve ekonomikë që përmbushin kapacitetet reale për kryerjen e këtij aktiviteti.

RREGULLORJA NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Ne si OE kërkojmë që pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim kërkojmë që ti përmirësoni, përkatësisht ti largoni kërkesat kufizuese dhe të aplikoni dispozitat e Nenit 53.7 të LPP-se.

Gjithashtu ju NUK e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Ju si Autoritet Kontraktues duhet të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të nxjerrin:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE ENG BAU SH.P.K, Rr. Azem Sylku
Thaqi Kamenice, Kamenice.

OBLIGOHET AK të largoj kërkesat kundërligjore, të aplikoni dispozitat e Nenit 53.7 të LPP-se si dhe duke korigjuar versionon e fundit të Dosjes së Tenderit në të cilën duhet të indentifikohen ndryshimet konform korigjimeve të bëra.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

I kemi shqyrtuar Kërkesat për rishqyrtim të OE "Global Holding" SH.P.K. dhe të OE NIKA PrO-Ing SH.P.K. dhe mund të konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara.

Kërkesa për Rishqyrtim të OE NIKA PrO- Ing SH.P.K. është e Jashtafatshme, meqenëse është bere me datën 29.10.2025 ndërsa hapja e ofertave është parapare për datën 03.10.2025.

Dita e Kërkesës për Rishqyrtim 29.10.2025 është dita zero (0).

Sipas nenit 60.1 (a) dita e dorëzimit të ofertave (03.10.2025) është dita zero (0).

30.10.2025 – dita e pare, 31.10.2025 – dita e dyte, 01.11.2025 – dita e trete, 02.11.2025 – dita e katërt.

Rregullorja nr. 001/2022 - Neni 60 - Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore **dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)**. Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Rregullorja nr. 002/2024 - Neni 63.2 - Vendimi i Autoritetit Kontraktues

Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë **vendim** në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtoj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej **3 (tre) dite pune** nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. **Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).**

Gjithashtu Kërkesa për Rishqyrtim të OE NIKA PrO- Ing SH.P.K. të Vendimi në faqe 4, i referohet OE ENG BAU SHPK që është kompani tjetër dhe nuk ka të bëjë me këtë OE.

Në fund kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të nxjerrin:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të OE ENG BAU SH.P.K, Rr, Azem Sylku
Thaqi Kamenice, Kamenice.

Sa i përket pretendimeve ankimore, te dy kërkesat për rishqyrtim janë te ngjashme, me te njëjtin pretendim ne lidhje me Kërkesën nr. 1 te kapaciteti ekonomik dhe financiar ne DT, kërkesa për 51% te plotësimit nga lideri i GOE.

AK-MSH konsideron se kjo kërkesë eshte plotësisht e drejte dhe jo diskriminuuese dhe eshte e bazuar ne UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, shih dispozitën faqe 33:

- Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:

Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbush se paku 51% e këtij qarkullimi minimal.

Kërkesa juaj për zbutje te qarkullimit 51% për liderin e GOE, nuk ka ndonjë efekt, përderisa plotësimi i 51% eshte kërkuar edhe për Referencat qe duhet ti plotësoj lideri.

Eshte praktike jo e mire atakimi i aktivitetit ne mënyrë direkte me kërkesë për rishqyrtim dhe pa e shfrytëzuar mundësinë e Sqarimeve Shtese, meqenëse shkakton pengese me pezullim te pa nevojshëm te procedurës, për çështje qe kane mund te trajtohen me sqarime ne kohen e duhur.

Ju si OE keni mundur qe këto pretendime ti adresoni përmes Sqarimeve Shtese ne kohen e përcaktuar për pyetje sqaruese dhe ne do u përgjigjeshim me sqarime shtesë si gjithë OE tjerë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit